

Behar Kaceli

**ORGANIZIMI I JETËS FETARE TE SHQIPTARËT PAS SHKËPUTJES
NGA KALIFATI OSMAN**

**ОРГАНИЗАЦИЈАТА НА ВЕРСКИОТ ЖИВОТ КАЈ АЛБАНЦИТЕ
ПО ОДВОЈУВАЊЕТО ОД ОТОМАНСКИОТ КАЛИФАТ**

**THE ORGANIZATION OF RELIGIOUS LIFE AMONG ALBANIANS
AFTER THE SEPARATION FROM THE OTTOMAN CALIPHATE**

Hyrje

Për të pasur një përfytyrim të qartë të jetës dhe të organizimit fetar në trojet shqiptare në përgjithësi dhe në *“Shqipërinë Londineze”* në veçanti, duhet të kemi parasysh të gjithë narrativen e ngjarjeve historike, që kanë shoqëruar historinë e shqiptarëve që nga akti i shpalljes së Pavarësisë e në vazhdim. Nuk do e teproja nëse do të thoja që duhet të shkojmë edhe më thellë në histori, që nga Rilindja dhe zgjimi ynë kombëtar e gjer në ditët e sotme. Gjatë shek. XVIII islami ishte konsoliduar në trojet shqiptare, gjë që bëri të mundur që fillim shek. XIX me ndryshimet social-politike që solli ai, shqiptarët t’i gjente të vetëdijshëm për përkatësinë e tyre etnike dhe fetare. Kjo i bënte ata të vetëdijshëm edhe për raportet me shtetet fqinje të sapokrijuara, me pushtetin qendror që ishte sulltanati po ashtu edhe me kalifatin që mishërohej me Sulltanin Osman.

Kriza lindore e viteve 1870 dhe impakti i saj gjeopolitik, bëri që zgjimi kombëtar të arrijë kulmin e tij si aktivitet politik, në të njëjtën kohë reflektoi dhe në raportet midis shqiptarëve dhe Sulltanit, si dhe në lidhjen shpirtërore të shqiptarëve myslimanë dhe Kalifit. Artikulimi i kësaj teze ka arritur kulmin nën penën e Sami Frashërit te vepra e tij *“Shqipëria çka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”*, kur shprehet edhe për organizimin fetar. Një Myfti i madh për myslimanët, një Eksark për ortodoksët dhe një kryepiskop për katolikët, këta do të vështrojnë gjithë punët e tri besëve në Shqipëri nën varësi të ministrisë së diturisë a

gjyqjit (arsimit ose drejtësisë), thekson ai.¹ Në të njëjtën kohë, ai e quan tradhti dhënien përparësi lidhjes fetare përpara asaj kombëtare.² Edhe në Lidhjen e Prizrenit shohim që faktori fetar është thelbësor në faktorët që çuan në organizimin e saj. Siç është theksuar nga shumë studiues perëndimor që i janë referuar një diplomati britanik në Kosovë gjatë asaj periudhe, i cili thoshte se: *“Lëvizja është më shumë një lëvizje fetare sesa shekullare, dhe udhëhiqet nga myftilerët, ulematë dhe kadinjtë. Jam i mendimit se tashmë Porta e Lartë dhe Lidhja janë në një mendje dhe po punojnë për të arritur një qëllim të përbashkët, mbrojtjen e provincës”*.³

Që shqiptarët ishin besnik ndaj Sulltanatit dhe Kalifatit shihet qartë edhe te kërkesat e saj drejtuar Portës së Lartë. Sami Frashëri i botoi kërkesat e Lidhjes në gazetën e drejtuar prej tij *“Terxhumani-Shark”*, ku theksohej që vilajetet shqiptare të bashkohen në një vilajet të vetëm, vilajeti të kishte një kuvend të përgjithshëm që mblidhej dy herë në vit, gjuha e shkollës dhe administratës të ishte shqipja dhe turqishtja të përdorej vetëm në komunikimin me pushtetin qendror, nëpunësit e tij të dini gjuhën shqipe, etj. Qëndrimi i Lidhjes së Prizrenit siç shihet edhe nga *“Kararnameja”* ishte centralist dhe në varësit ë Portës së Lartë.⁴ Në fakt, përdorimi i gjuhës shqipe, apo emërimi në poste administrative të nëpunësve që flisnin shqip, gjatë sundimit osman në Shqipëri nuk ka qenë diçka e panjohur. Në shumicën e rasteve vetë administrata qendrore osmane ka qenë e interesuar për emërimin në provincat shqiptare të personave që dinin shqip dhe që njihnin zakonet dhe traditat. Në vitin 1880, në kazatë e Durrësit, si: Tirana, Kavaja, Shijaku, Peqini, emërohen kajmekam persona që flasin gjuhën shqipe dhe që njohin strukturën shoqërore të zonës, kjo evidentohet në dokumentet zyrtare të kohës.⁵ Zaten, osmanët që në fillimet e tyre i njihnin mirë shqiptarët dhe identitetin e tyre të ndryshëm nga grekët dhe sllavët. Kjo vihet re edhe në organizimin administrativ, ku Sanxhaku Arvanid (sanxhaku i shqiptarëve), u konturua në bazë të përkatësisë së

¹ Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe ç’do të bëhet, Albaniana 2015, f. 82.

² Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe ç’do të bëhet, po aty, f. 95.

³ Olsi Jazexhi, *“Mbi identitetin islamik të Lidhjes së Prizrenit (Prizren Ittifaki)”*, Mesazhet e Lidhes së Prizrenit, Prizren, 12 Qershor 2007, f. 118.

⁴ Peter Bartl, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarsi kombëtare (1878-1912), Dituria 2006, f. 141-159.

⁵ Shqipëria në Dokumentet Osmane (*Osmanlı Arşiv Belgelerinde Arnavutluk*), İstanbul 2008, f. 27.

tij etnike.⁶ Ajo që është më e rëndësishme dhe që duhet theksuar është se edhe dokumentet e para të lëvuara në gjuhën shqipe, të hasura gjer më tani, qofshin ata me alfabet latin, si “*Formula e Pagëzimit*” 1492, si dhe ata me alfabet osman, i përkasin pikërisht periudhës së sundimit osman në trojet shqiptare.⁷

Këto dinamika dhe mënyra se si rrodhën ato, bënë që shqiptarët mysliman të angazhoheshin me tërë fuqinë e tyre si dhe ta kalonin çështjen e shpëtimit kombëtar në çështje besimi. Siç është theksuar nga shumë studiues shqiptarë dhe të huaj se “*Feja islame kryente edhe funksione të ideologjisë shtetërore. Islamizmi ishte rregulluesi, sovran dhe absolut i shtetit në mënyrë të tillë që Kurani dhe Kodi Civil ishin një gjë e vetme dhe që dogma, duke u identifikuar me nderimin shtetëror, i jepte këtij të fundit karakter të pandryshueshëm dhe ekzekutiv. Ushtrimi i pushtetit konsiderohej si një akt fetar. Xhamia ishte faltore, shkollë dhe gjykatë, kurse Kurani, libri i shenjtë- kodi dhe kushtetuta*”.⁸ Rreth shkëputjes së shqiptarëve nga Kalifati akoma edhe sot e kësaj dite ka debate se kur dhe si u shkëputën ata. Për disa, pavarësia shënon shkëputjen e muslimanëve shqiptarë nga Kalifati, për disa të tjerë themelimi i Komiteti Mysliman Shqiptar shërben si momenti dhe akti i shkëputjes së shqiptarëve nga Kalifati, për disa të tjerë është vetë rënia e institucionit të Kalifit momenti kur shqiptarët ngelen pa Kalif.

Organizimi i fesë islame pas shpalljes së Pavarësisë dhe themelimi i KMSH-së

Siç ishte trashëguar edhe nga aktiviteti patriotik i dijetarëve mysliman gjatë shek. XIX, edhe shpallja e pavarësisë i gjeti ata në krye të angazhimeve historike dhe ngjarjeve të mëdha, që do të pasonin në vendin tonë. Ishin pikërisht ata prijës që hodhën themelet e institucioneve kryesore shtetërore dhe krahas tyre themeluan edhe institucionet e larta fetare në vend, si: institucioni i kryemyftiut, gjyqi i naltë i sheriatit, etj. Gjithashtu këta dijetarë momentet më të rëndësishme historike të vendit tonë i shoqëruan me fetvatë e tyre për legjitimitetin e tyre, si: pavarësimi nga sulltanati, përdorimi i simboleve në flamur, përdorimi i alfabetit latin, etj. Gjatë bashkëqeverisjes qindra vjeçare të shqiptarëve në Perandorinë

⁶ Ali Galip, Histori rreth Shqipërisë dhe shqiptarëve, Botimet Alsar, Tiranë 2023, f. 21-67.

⁷ Feti Mehdiu, “Gjendja arsimore-edukative në Kosovë në periudhën Osmane dhe Post-Osmane”, Ura, Nr. 2/1, A. C. F. O. S, Tiranë 2009, f. 18-25.

⁸ Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, Tiranë 2011, f. 18.

Osmane, hasim shumë emra dijetarësh dhe hoxhallarësh nga trojet shqiptare që kanë shërbyer në vende të ndryshme si myderrizë, myftilerë, kadilerë, naibë etj. Në atë kohë, në trojet shqiptare u ndërtuan shumë objekte edukativo-arsimore, si: mejtepe, medrese, rruzhdiqe, idadiqe, etj. Sipas Evlija Çelebiut, në trojet tona kanë ekzistuar edhe institucione arsimore të specifikuara, si: darul-kur'ra, darul-hadith, etj.⁹

Edhe medresetë e trojeve shqiptare kishin një nivel të kënaqshëm akademik dhe nxirrnin njerëz të aftë për administratën shtetërore. Një nga këto modele të medreseve të atëhershme është edhe ajo e Konispolit, që për fat të keq Konispoli i sotëm nuk përputhet me asnjë përshkrim me Konispolin e atëhershëm, mirëpo ajo nxirrte nxënës që me atë diplomë regjistroheshin në medresetë e Stambollit dhe në Ez'her të Kajros, që ishte institucioni më i lartë arsimor fetar në botë.¹⁰ Ç'mund të thuhet për medresetë e Shkodrës, Gjirokastrës, Elbasanit, Beratit, Shkupit, Prizrenit, etj. Deri në momentin e pavarësimit të shqiptarëve më 28 Nëntor 1912, organizimi i çështjeve dhe jetës fetare në trojet tona, bëhej nën drejtimin e institucionit të "*Shejhul-Islami*" me qendër në Stamboll.

Pas shpalljes së pavarësisë, do të shohim se shumica e burrështetasve shqiptarë ishin patriotët dhe dijetarët mysliman. Shumica e tyre, kadilerë, myftilerë, imamlarë, të cilët iu përveshën punës për krijimin e shtetit shqiptar. Shembulli tipik i kësaj që thamë është fakti që Vehbi Dibra, i zgjedhur në krye të Pleqësisë (parlamentit), u ngarkua nga kuvendi edhe me detyrën e Kryemyftiut të Shqipërisë. Ai njihej si (*Shejhul-Islam dhe Kadi'l-Kudat*),¹¹ emërtime këto të trashëguara nga tradita administrative islame. Ai menjëherë filloi një veprimtari intensive për organizimin dhe reformimin e institucioneve fetare, si: kadilerët, myftilerët, zyrat e sheriatit, etj. Këto dhe akte të tjera ai ia paraqiti qeverisë së Vlorës më 5 maj 1913, ku edhe u morën vendimet përkatëse. Nga vendimet e qeverisë në këtë mbledhje ishte që çështjet civile dhe ato penale t'i kalojnë organeve të drejtësisë dhe suprimimi i institucionit të kadiut. Gjithashtu u vendos që shikimin dhe gjykimin e padive dhe çështjeve fetare që më parë i kishin bërë kadilerët t'u kalojë myftilerëve, u vendos emërimi e një myftiu në çdo prefekturë me pagë 1800 grosh dhe çdo nënprefekturë me rrogë 1200 grosh. Vehbi Dibra mban titullin

⁹ Feti Mehdiu, "*Gjendja arsimore-edukative në Kosovë në periudhën Osmane dhe Post-Osmane*", po aty, f. 19.

¹⁰ Ibrahim Hoxha, "*Medreseja e Konispolit qendër e madhe dijesh dhe kulture*", Univers Nr. 2, AIITC 2002, f. 129.

¹¹ Qazim Xhelili, Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar I lëvizjes kombëtare. Tiranë, Albin 1998.

“*Shejhul-Islam*” i Shqipërisë dhe funksioni i myftilerëve dekretohet prej tij. Kjo bie në sy edhe në një telegram që Vehbi Dibra e nënshkruan nga Durrësi me titullin si Myfti i Përgjithshëm i Shqipërisë, që iu kishte dërguar nxënësve të medresesë së Beratit ku u thoshte se “*detyra fetare dhe atdhetare e lyp me dalë në luftë për me mbrojtun atdheun*”.¹² Siç bie në sy, për organizimin e brendshëm të fesë islame, qeveria e Vlorës aplikoi statuskuonë tradicionale të trashëguar, por duke eliminuar varësinë institucionale nga “*Shejhul-Islam*” i Stambollit.

Për herë të parë në historinë e saj, Shqipëria kishte kryemyftiun e vet të emëruar nga qeveria e saj. Administrata fetare u krijua paralel me atë shtetërore, prefekturës i përgjigjej myftiu, nënprefekturës nënmyftiu. Kjo administratë ishte në varësi të qeverisë. Me shpalljen e pavarësisë edhe Gjyqi i Naltë i Sheriatit, i trashëguar nga sundimi osman, i shkëputi lidhjet me Kalifatin. Nga pavarësia e gjer në Kongresin e Lushnjës nuk u shfaqën probleme fetare apo përplasje të institucioneve fetare me ata qeveritare. Me reformat që bëri qeveria e Vlorës, të cilat filluan më 5 maj 1913, qeveria vendosi suprimimin e institucionit të kadilerëve dhe shqyrtimin e padive fetare ia kaloi myftinjve. U krijuan gjykatat civile shtetërore që vareshin prej Ministrisë së Drejtësisë dhe që administroheshin prej kadilerëve dhe vepronin me ligjin islam. Ishte vendimi i Këshillit të Ministrave të 1 dhjetorit 1920 ai që ia hoqi kompetencat dhe të drejtën kadilerëve dhe mitropolitëve të merrnin pjesë në këshillat administrative. Pas vitin 1920, institucionet fetare u riorganizuan totalisht dhe atyre iu mbetën vetëm detyrat e thjeshta fetare.¹³ Më vonë qeveria e Vlorës do të merrte vendimin e lirit të Vehbi Dibrës nga detyrat e tjera shtetërore dhe të angazhimit të tij total vetëm me çështjet e fesë. Vendimin e qeverisë që Vehbi Dibra të lirohet nga detyra e Kryetarit të Pleqësisë dhe në vend të tij u emërua Ekrem Vlora, e lajmëroi Gazeta “*Dielli*” më 27 shtator 1913.

Rreth sovranitetit të sulltanit dhe varësisë së shqiptarëve ndaj Shejhul-Islamit, edhe fuqitë e mëdha nuk është se kishin ndonjë kundërshtim. Pas shpalljes së pavarësisë gjatë diskutimit rreth sovranitetit të Sulltanit, nga fuqitë e mëdha, si: Itali, Austro-Hungaria dhe Franca diskutohet se sovraniteti do të jetë sa për sy faqe dhe s’ka të bëjë aspak me organizimin e brendshëm të shtetit shqiptar. Në u heqte sovraniteti, myslimanët do ti ruajnë lidhjet fetare me Kalifin si gjithë myslimanët e

¹² AQSH, Fondi 482, Dosja 1, f. 1. Më shumë: Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, f. 19.

¹³ Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 19.

tjerë të viseve që janë ndarë politikisht prej Turqisë.¹⁴ Gjithashtu edhe për sa i përket përdorimit të ligjeve të sheriatit në gjykata apo përdorimit të gjuhës turke, nuk është se kishte ndonjë kundërshti. Kristo Floqi, në gazetën zyrtare të qeverisë së Vlorës “*Përlindja e Shqipërisë*”, kur flet për gjyqësinë dhe organizimin e saj në Shqipëri, thotë se shumica e nëpunësve të qeverisë nëpër rrethe “*i bëjnë punët allaturka*”, gjë që tregon trashëgiminë e administratës osmane. Hë për hë janë të nevojshme “*nomet e tyrqisë*”, thotë ai, se nuk jemi në gjendje të përgatisim të tonat në këto kushte.¹⁵ Detyrën e kryemyftiut të Shqipërisë Vehbi Dibra do ta mbante gjer në fund të jetës së tij. Duke shfletuar “*Librin e Jetëshkrimeve të Nënpunësave*”, për Vehbi Dibrën konstatojmë se nën punësia e tij është shënuar “*Myfti i Përgjithshëm*”, ndërsa për datën e fillimit të detyrës është shënuar “*Qysh se u ba Shqipnia*” e gjer në dorëheqjen e tij.

Edhe me ardhjen e Vidit në pushtet, siç e pohon vetë Vehbi Dibra, ai ka mbajtur postin e Kryemyftiut gjersa është burgosur gjatë kryengritjes së Shqipërisë së Mesme me akuzën se ka dhënë fetva për ngritjen e flamurit. Pas shuarjes së trazirave, Esat Pasha e thërret Vehbi Dibrën që të vazhdonte detyrën e tij ku e ngarkoi me detyrën “*kryetar diktimi dhe kryemyfti*”. Gjatë sundimit austriak, ishte përsëri Vehbi Dibra ai që do të mbante postin e kryemyftiut. Në vitin 1916, në Shkodër u themelua Gjyqi i Naltë i Sheriatit, i cili do të shërbente si institucion zyrtar që organizonte jetën fetare myslimane në të gjithë Shqipërinë. Kryetar i tij do të ishte përsëri Vehbi Dibra, përkrah statusit si kryemyfti i vendit. Në krah të kryetarit kishte edhe dy anëtarë (*këshilltari dhe fetva emini*), dy sekretarë dhe dy shkrues¹⁶. Kryemyftiu i vendit dhe institucioni i Gjyqit të Naltë vazhduan të jenë institucionet më të larta dhe të vetme fetare deri në Mars 1923. Këtë detyrë ai e mbajti edhe gjatë Qeverisë së Durrësit, edhe pas formimit të Qeverisë së Lushnjës ai u ngarkua me detyrën e Kryemyftiut. Edhe pas ardhjes së Ahmet Zogut në pushtet si President u ngarkua me këtë detyrë, gjithashtu edhe pasi u ndryshua sistemi në mbretëri përsëri Vehbi Dibra do të mbante postin e kryemyftiut. Këtë gjë Vehbi Dibra e ka konfirmuar vetë gjatë fjalimit të mbajtur në punimet e Kongresit III Musliman më 1929.¹⁷

¹⁴ Xhaferr Sadiku, Shqipëria 1878-1928: roli i elitës politike, Pika pa Sipërfaqe, Tiranë 2021, f. 260-261.

¹⁵ Gazeta “*Përlidja e Shqipënisë*”, Viti 1, Nr. 3, Gusht 1913, f. 2-3.

¹⁶ AQSH, Fondi 882, Dosja 19, f. 30.

¹⁷ AQSH, Fondi 482, Dosja 3, f. 3.

Në fillimin e vitit 1923, kryeministri i vendit Ahmet Zogu, i kërkoi Gjyqit të Naltë të Sheriatit një raport sesi mund të formohej bashkësia islame shqiptare, e cila në atë kohë njihej si “*Xhem’ijeti Islamijje*”. Si përgjigje e kësaj kërkese, Këshilli i Naltë njofton se e sheh të domosdoshme formimin e kësaj bashkësie dhe për këtë arsye kërkon ndihmën e qeverisë në aspektin organizativ, si: përzgjedhjes së delegatëve, organizimit të kongresit, përgatitjes së infrastrukturës së nevojshme dhe sigurimit të buxhetit për mbajtjen e kongresit. Kongresi I Mysliman u mbajt më 24-02 deri më 12-03-1923. Vlen të përmendet fakti se në atë kohë, në lidhje me organizimin e këtij kongresi, pati disa kundërshtime nga disa hoxhallarë të Shkodrës me pretendimin e “*ndërhyrjes*” së shtetit në zgjedhjen e delegatëve dhe mos respektimin e numrit proporcional të tyre (*kërkohej që Shkodra të kishte më tepër delegatë*). Kundërshtim dhe mosnjohje të vendimeve të kongresit pati edhe nga bashkësia e bektashinjve, të cilët shpallën pavarësinë e tyre dhe organizuan një kongres të veçantë. Myftiu i përgjithshëm sqaroi në një telegram se kongresi nuk kishte për synim përçarjen e myslimanëve dhe as themelimin e një dege dhe përjashtimin e degëve të tjera të Islamit, por kishte për qëllim bashkimin e myslimanëve dhe përmirësimin e organizimit të çështjeve fetare islame.¹⁸

Pas këtij kongresi, u hartua statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar (*Xhem’ijeti ose Xhemaati Islamijje*) dhe këshillat drejtues të këtij institucioni u përcaktuan të ishin si më poshtë: Divani i Ulemave (5 persona me në krye shejhu’l Ulema ose Myftiu i Përgjithshëm). Këshillat e Ilmijjes (myftinj të dhe këshillat e myftinive). Këshillat e xhimateve. Gjithashtu, nga vendimet e kongresit ishte edhe përgatitja e rregullores për organizimin e vakëfeve, nxjerrja e një organi zyrtar të quajtur revista “*Zani i Naltë*” dhe themelimi i Medresesë së Naltë të Tiranës. Kongresi I Mysliman pati jehonë edhe jashtë vendit ku u shoqërua edhe me dezinformacione të ndryshme që si burim patën gazetën “*Politika*” të Beogradit, se gjasmë kongresi ka marrë vendime që bien ndesh me parimet islame, jehonë kjo që gjeti vend edhe në shtypin egjiptian dhe turk. Gjë për të cilën edhe vetë Vehbi Dibra u detyrua të japë një sqarim që u botua në gazetën “*Sebilu’r-Reshad*” në Stamboll.

¹⁸ Ali M.Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, f. 64-65;69-71.

Sqarimi i kryemyftiut të Shqipërisë Mehmet Vehbi Dibra në lidhje me vendimet e Kongresit të Parë Mysliman Shqiptar

Para disa kohësh na kanë ardhur telegrame nga qendra të ndryshme të Evropës, ku thuhet se në Shqipëri, pikërisht në Kongresin Mysliman Shqiptar të mbajtur në Tiranë, është vendosur shkëputja nga Halifati Islam, heqja e detyrimit të abdesit, mos bërja e rukusë dhe sexhdes gjatë namazit, ndalimi i martesës me më shumë se një grua dhe ndalimi i mbulesës për femrën.

Këto fjalë kanë çuditur të gjithë botën Islame, por më shqetësues është fakti se ato janë përmendur edhe në disa organe shtypi në Egjipt, një vend ku jetojnë edhe shumë vëllezër tanë myslimanë shqiptarë. Njëri prej këtyre, gjatë një udhëtimi për në vendlindje (Shqipëri) kishte marrë me vete këto shkrime, të cilat i paraqiti para Myftiut të përgjithshëm dhe njëkohësisht Kryetarit të Këshillit të Naltë të Sheriatit, Mehmet Vehbi Efendi Dibrës. Mes të tjerave ai u lut për një sqarim publik në lidhje me këto fjalë të përhapura. Nisur nga sa më sipër, në përgjigje të kërkesës së këtij personi dhe si sqarim të së vërtetës, po sjellim më poshtë tekstin e përkthyer të letrës së dërguar nga ana jonë, në gazetën e quajtur el Ahbar, e cila botohet në qytetin e Kajros. “Në gazetën el-Ahram të datës 11 Prill dhe në gazetën el-Mukattam të datës 17 Prill, lexova rreshtat që flisnin për Kongresin e Myslimanëve shqiptarë dhe gjoja të ashtuquajtura vendime të tij. Me thënë të drejtën u shokova dhe mbeta pa fjalë kur lexova këto gjëra të paqena, madje këto shpifje pa asnjë bazë. Jo më një institucion, por qoftë dhe një mysliman i thjeshtë, që ka lidhje qoftë edhe një grimcë me fenë e tij, nuk mund të imagjinohet kurrë që të thotë gjëra të tilla. Të gjitha këto shpifje nuk janë gjë tjetër veçse tentativa për të mbjellë farën e armiqësisë dhe për të shkatërruar unitetin e myslimanëve, e këtë e kupton shumë lehtë çdo mysliman. E për më tepër, këto shpifje bëhen edhe më të pabesueshme kur thuhet ndaj shqiptarëve, të cilët njihet botërisht për besnikërinë e tyre ndaj besimit dhe fesë që i përkasin. Në kongresin tonë të mbajtur në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, janë bërë diskutime të ndryshme dhe janë marrë edhe vendime, por që të gjitha këto kanë qenë pro bazave të besimit dhe sheriatit tonë dhe me qëllimin e vetëm të lartësimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të Islamit në trojet shqiptare. Të gjitha vendimet e marra, si: themelimi i Komunitetit Mysliman Shqiptar në të gjithë trojet e Shqipërisë, rregullimi dhe zhvillimi i vakëfeve publike, sistemimi i objekteve tona të adhurimit, sistemimi i shërbimeve të

bamirësisë, zhvillimi dhe kryerja sa më mirë e detyrave publike fetare, ringjallja dhe përhapja e botimeve Islame brenda dhe jashtë vendit etj, janë në përputhje të plotë me bazat islame dhe synojnë realizimin e dëshirave dhe ëndrrave të myslimanëve shqiptarë. Edhe njëherë deklaroj indinjatën time dhe distancohem nga shpifjet e shkruara në gazetat “El-Ahram” dhe “El-Mukattem”. Përsëris, se këto shpifje nuk kanë qëllim tjetër përveç çorientimit dhe hipokrizisë, goditjen e unitetit mysliman dhe dëmtimin e imazhit të myslimanëve shqiptarë nëpër botë. Njëkohësisht falënderoj dhe vlerësoj shumë, të gjithë ata miq e vëllezër egjiptianë, të cilët nuk janë ndikuar nga fjalë të tilla, por përkundrazi na kanë dalë në krah duke mos pranuar këto shpifje të ulëta. Së fundmi, edhe njëherë, hedh poshtë dhe mohoj prerazi të gjitha shpifjet e thëna më sipër.”¹⁹

Kryemyftiu i Shqipërisë dhe Kryetari i Këshillit të Naltë

Sheriatit;

I varfri te Zoti: Mehmet Vehbi Dibra;

Data: 22 Shevval 1341 (7 Qershor 1923).

Ky kongres u pasua edhe me dy kongrese të tjera të mbajtur përkatësisht në vitet 1925 dhe 1929. Që nga viti 1912 e deri më 1929, drejtuesi më i lartë i bashkësisë islame shqiptare ka qenë Vehbi Ef. Dibra. Gjatë punimeve të kongresit të tretë mysliman (1929) Vehbi Dibra jep dorëheqjen nga posti më i lartë drejtues fetar. Me vota unanime kryetar i Komunitetit Mysliman zgjidhet Behxhet Shapati, i cili e drejtoi institucionin deri në vitin 1942. K.M.Sh, gjatë historisë së tij ndërmori shumë reforma organizative, por përkrah kontributeve fetare dhe shoqërore shumë të mira, ajo u ballafaqua me shumë sfida, të cilat në shumicën e rasteve ishin të natyrës financiare. Por nuk munguan as sfidat e karakterit politik, që vinin si pasojë e ndryshimeve të qeverive që drejtuan Shqipërinë e atyre viteve²⁰. Sfidat dhe vështirësitë e këtij institucioni u rritën ndjeshëm që me instalimin e sistemit komunist në vitin 1945 dhe kulmi i tyre ishte në vitin 1967²¹. Në vitin e mbrapshtë 1967, sistemi monist, pasi kishte dobësuar ndjeshëm rolin e fesë dhe të klerit, mbylli të gjitha institucionet fetare në vend, nxori ligjin që ndalonte kryerjen e ritualeve fetare publikisht dhe fshehurazi dhe

¹⁹ Shqipëroi: Ferid Piku, “Sebilur-Reshad”, Vol. 21, Nr. 544-545, f. 198.

²⁰ Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 207-209.

²¹ AQSH, Fondi 482, Dosja 22, f. 1.

deklaroi botërisht se Republika e Shqipërisë do të ishte një shtet ateist²². Drejtuesit e KMSH gjatë periudhës 1942-1967 kanë qenë me radhë: Hafiz Sherif Lëngu (1942-1945), Hafiz Musa H. Ali Basha (1945-1954), Hafiz Sulejman Myrtaj (1954-1966), Esat Myftija (1966-1967).

Dijetarët mysliman shqiptarë, kanë qenë vizionarët e parë të ndërtimit të shtetit kombëtar shqiptar. Pavarësisht se qarqe të ndryshme u munduan të krijonin një hendek ndërmjet elitës islame dhe elitës laike dhe që për fat të keq ky hendek u thellua dhe u zgjeruar akoma më shumë gjatë sundimit komunist dhe që u ndje gjer në fund të shek. XX. Dijetarët mysliman kanë dhënë një kontribut të pasqor në forcimin e ndjenjës kombëtare dhe atdhetare, ku më i spikaturi prej tyre është Hafiz Ali Korça, ku me poezinë “*Myslimanizma dhe Nasjonalizma*” e shprehte me habi platformën e ndërtuar nga disa qarqe se gjasme nacionalistët janë atdhetarë dhe fetarët jo atdhetarë.²³

Myslimanizma dhe nasjonalizma.²⁴

Mua nga ca njerës më vjen mjaft pështirë, nasjonalizmën se gjykojnë mirë.

Nasjonalistët qënkan shqipëtarë, fetarët nuk qënkan as pak atdhetar!

Të tjerët për kundra çështjen e gjykojnë, nasjonalistët pa fe i shikojnë.

Nuk po e gjykojnë mirë të dy palët, pak t'i shpjegojmë ani të dy fjalët.

.....

Nasjonalist jam po, fetar si duhet. Le të thonë bota ashtu si t'u thuhet.

Hafiz Aliu, vetë i përket asaj elite islame që është përndjekur dhe përbuzur vazhdimisht nga të gjitha regjimet. Mirëpo faktet historike janë kokëfortë dhe dëshmojnë se janë pikërisht kjo elite intelektuale fetare që ka dhënë kontributin më të madh që nga Lidhja e Prizrenit e në vazhdim. Hafizi i nderuar do të jepte një kontribut tepër të çmueshëm për arsimin dhe shkollën shqipe, që ishin themeli bazë i ndërtimit të shtetit shqiptar, dhe atë do ta gjejmë në pararojë në të gjithë kongreset dhe kuvendet kombëtare ku më shumë spikati në “*Kongresin e Dibrës*”.²⁵

²² AQSH, Fondi 511, Dosja 20, f. 24.

²³ Feti Mehdiu, “*Vizioni real i H. Ali Korçës për ndërtimin e shtetit kombëtar*”, Ura, Nr. 8-9, A. C. F. O. S, Tiranë 2012, f. 94-104.

²⁴ Zani Naltë, Nr. 4, Janar 1924, Botim KMSH, Tiranë 2015, f. 105.

²⁵ Për më shumë: Bedri Telegrafi, “*Kontributi i H. Ali Korçës për arsimin dhe shkollën shqipe*”, Ura, Nr. 8-9, A. C. F. O. S, Tiranë 2012, f. 105-115.

I të njëjtës plejadë vuajtjesh dhe kontributesh për kombin shqiptarë është edhe hafizi tjetër i nderuar Ibrahim Dalliu. Ai ka hyrë në historinë e kulturës shqiptare me të gjitha tiparet e një rilindësi, si njeri i penës e pushkës, një figurë shumëdimensionale dhe një figurë e shquar. Edhe ky, për fat të keq, vuajti dhe u përbuz nga të gjitha regjimet shqiptare.²⁶ Pa frikë mund të thuhet se kontributin më të madh dhe më të gjërë për forcimin e mendimit dhe identitetit kombëtar shqiptar e kanë dhënë publicistë mysliman shqiptar. Në gjysmën e dytë të shek. XIX, intelektualë dhe shkrimtarët mysliman shqiptarë u bënë shpallës të mendimit kombëtar shqiptar.²⁷ Do të bëheshin vërtetë shumë nëse do të fillonim të numëronim që nga vëllezërit Frashëri, e gjer te publicistët e fillim shek. XX.

Krijimi i Gjyqit të Naltë të Sheriatit

Siç e kemi theksuar edhe më lart, me pavarësinë e Shqipërisë morën jetë edhe institucionet e para shtetërore dhe fetare. Ndër institucionet më të rëndësishme fetare që u krijuan në vend dhe që në dukje është pak paradoksale, në krahasim me realitetin e sotëm, është edhe institucioni i Gjyqit të Naltë të Sheriatit. E gjithë struktura e gjykatave shariatike disa shekullore që ishte trashëguar nga Perandoria Osmane, pas shpalljes së pavarësisë i shkëputi lidhjet me kryekadiun në Stamboll. Struktura e gjykatave vazhdoi ashtu siç ishte trashëguar nga Perandoria Osmane, por në varësi të qeverisë së Vlorës, për këtë na vjen në ndihmë edhe qarkorja e kryekadiut të qeverisë së Vlorës, ku i drejtohej prefekturave të Durrësit, Beratit dhe Elbasanit mbi organizimin e gjyqeve në të gjitha krahinat.²⁸ Gjithashtu një dokument tjetër që na vjen në ndihmë për organizimin e gjykatave është edhe një qarkore e vitit 1913, ku Kryekadillëku i Qeverisë së Vlorës raporton për problemet financiare që janë krijuar pas suprimimit të disa zyrave të sheriatit.²⁹

Në vitin 1916, komanda ushtarake austro-hungareze në Shkodër formoi Gjyqin e Naltë të Sheriatit, i përbërë nga Kryemyftiu Vehbi Dibra dhe dy anëtarë të tjerë, një kryesekretarë dhe dy shkruesa

²⁶ Xhemal Balla, "Kontributi i H. Ibrahim Dalliu në historinë e kulturës dhe shkencës islame", Ura, Nr. 8-9, A. C. F. O. S, Tiranë 2012, f. 110.

²⁷ Peter Bartl, Myslimanët shqiptar në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912), Dituria, Tiranë 2006, f. 160.

²⁸ AQSH, Fondi 145, Dosja XVII/1, f. 1.

²⁹ AQSH, Fondi 145, Dosja XVII/2, f. 1.

(sekretarë).³⁰ Një vit më vonë, komanda ushtarake austro-hungareze miratoi “*Parashkresën e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri*”, e cila përbëhej nga 43 nene dhe deri në vitin 1923 luajti rolin e një statuti themeltar të këtij institucioni. Sipas këtij dokumenti, në krye të bashkësisë islame dhe të organizimit të Sherisë ishte Myftiu i Përgjithshëm, ai është myfti i përgjithshëm dhe kryekadi (kadi i kadivet). Nën varësinë e tij ishin të gjithë hoxhallarët dhe gjyqtarët e sherisë, si: myfti, kadi, naibë, ashtu edhe të gjithë zyrtarët e tjerë të gjykatave shariatike. Myftiu i përgjithshëm kishte drejtimin e të çështjeve fetare islame, themelimin e organizmave të bamirësisë si dhe arsimin e muslimanëve. Sipas këtij statusi themeltar, Këshilli i Naltë i Sheriatit përbëhej nga myftiu i përgjithshëm dhe dy ulema, njëri nga të cilët mbante titullin “*këshilltar*” ndërsa tjetri “*I besueshmi i fetvasë*”,³¹ një emërtim ky i huazuar nga sistemi osman që njihet si “*fetva-emini*”.

Ky këshill kishte të drejtë të emëronte gjyqtarët e sherisë, imamët, hatibët, hoxhallarët, mësuesit e besimit, etj. Në këtë parashkresë parashikoheshin edhe situata për shkarkimin apo për gjykimin e anëtarëve të Këshillit të Naltë si dhe mënyrën e zgjidhjes së ngërçeve që mund të lindnin. Gjithashtu përcaktoheshin edhe detyrat e Kryemyftiut si dhe të Këshillit të Naltë. Në bazë të nenit 9 të kësaj rregulloreje, gjykatat e sheriatit, që ishin nën drejtimin e një myfti-kadiu, quheshin gjykata të shkallës së I, ndërsa ato që ishin nën drejtimin e një naibi, gjykata të shkallës së II. Gjatë kësaj kohe u ngritën gjykata në të gjitha kryeqendrat e qarqeve, si: në Shkodër, Tiranë, Elbasan, Berat, Lezhë, Pukë, Krujë, Mat, Durrës, Shijak, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Gramsh, Fier, Ballsh, Skrapar, Peshkopi, Lumë, Gorë, Has dhe Krasniq.

Komanda Austriake në Shkodër dukej se kishte ndikim në mbarë-vajtjen dhe funksionimin e këtyre gjykatave, kjo shihet te korrespondenca e vitit 1917 ndërmjet Drejtorisë së Drejtësisë së Korpskomandës Austriake dhe Gjykatës së Naltë të Sheriatit rreth emërimit, shkarkimit, transferimit, marrjes së masave disiplinore ndaj kuadrit të gjykatave të sheries.³² Gjithashtu Komanda Ushtarake Austriake u përcaktonte edhe kompetencat dhe juridiksionin që ato kishin.³³ Drejtoria e Drejtësisë pranë Komandës Austriake i pezullonte dhe urdhëronte mos

³⁰ Dorian Demetja, 100 vjet Komuniteti Mysliman i Shqipërisë 1923-2023, Botim i KMSH, Tiranë 2023, f. 13.

³¹ Parashkresë e përkohshme për organizimin e Sherisë në Shqipëri, Komanda e naltë në Shqipëri, Shkodër 1917, f. 1.

³² AQSH, Fondi 155, Dosja 22, f. 1-27.

³³ AQSH, Fondi 155, Dosja 46, f. 1.

përmbardimin e vendimeve të gjykatave të shariatit që janë dhënë jashtë kompetencave të tyre. Kjo vihet re te korrespondenca e kësaj drejtorie me gjykatat civile të rretheve Gramsh, Lezhë dhe Fier në vitin 1918.³⁴ Vartësit e Këshillit të Naltë të Sheriatit ishin: 1) Myftinjët e qarqeve; 2) Sekretarët e vakfeve, 3) Sekretarët e sherisë, të cilët merreshin me kurorëzimet, shkurorëzimet, etj. 4) Mytevelijët (administratorët), që administronin dhe kujdeseshin për mirëmbajtjen e pasurive vakëfnore dhe të faltoreve. Autoritetet Austro-Hungareze në Shqipëri, e konsideronin territorin shqiptar si autonom dhe jo territor i pushtuar, për këtë arsye ai duhej të kishte institucionet e tij të pavarura, si i tillë duhej edhe një institucion i lartë islam i pavarur.

Austro-Hungaria pas krijimit të Kryekadillëkut në Shqipëri u përpoq që të merrte miratimin dhe njohjen e tij nga Stambolli dhe në mos u arritë kjo të paktën të merret një aprovim nga Reisul-Ulema në Sarajevë. Autoritetet Austro-Hungareze në Shqipëri, i kishin propozuar ministrisë së jashtme në Vjenë, që të silllej në Shqipëri Reisul-Ulema i Bosnjës bashkë me një grup hoxhallarësh boshnjak, të cilët të shëtisnin në territoret e kontrolluara nga Austro-Hungaria në Shqipëri dhe të bënin propagandë për bindje ndaj autoritetit ushtarak Austro-Hungarez. Gjithashtu ata kërkuan ndërhyrjen e diplomacisë vjeneze në Stamboll ku të sigurohej një lloj njohje për autoritetin e Kryekadiut në Shqipëri.³⁵ Me gjithë qëndrimet e ndryshme dhe në disa raste edhe zvarritje të qëllimshme nga autoritet Austro-Hungareze, në përgjithësi kjo ishte një klimë pozitive dhe një përpjekje e autoritetit ushtarak Austro-Hungarez në Shqipëri për të fituar simpatinë e popullatës myslimane shqiptare.

Në vitin 1919, Gjyqi i Naltë i Sheriatit iu drejtua qeverisë shqiptare në Durrës, ku me anë të një shkrese e vinte në dijeni për emërimin e një kadiu të fetvave. Në komunikim theksohej, *“Gjyqi i Naltë i Sheriatit që kur u formua në Shkodër dhe duke u mbështetur në nenin 29 të Parashkresës së Organizimit të Sheriatit, ka emëruar një gjyqtar të fetvave me një rrogë 320 korana, detyra e tij është të shqyrtojë aktet e davanave, etj. Duke qenë se kemi nevojë të madhe për një gjyqtar fetfanash dhe ai vend sot gjendet i zbrazët, ky gjyq sheh for të arsyeshme që të emërohet kadi, myftiu i Elbasanit Raif Efëndiu”*.³⁶ Parashkresa e hartuar që nga koha e Austro-Hungarisë, ka luajtur rolin e një statuti

³⁴ AQSh, Fondi 155, Dosja 152, f. 3.

³⁵ Sali Kadria, *“Qëndrimi i autoriteteve Austro-Hungareze ndaj popullsisë dhe klerit mysliman shqiptar gjatë viteve 1916-1918”*, Studime Historike, Nr. 3-4, Tiranë 2019, f.

³⁶ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri, po aty, f. 21.

bazë deri në vitin 1923. Krahas Parashkresës për Organizimin e Sherive si dhe asaj për organizimin e vakëvefe të hartuara gjatë sundimit Austro-Hungarez, do tu shtohet edhe rregullorja për organizimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit.

Gjithashtu nga dokumentet arkivore na bëhet e qartë se gjykatat civile të shtetit administroheshin prej kadilerëve dhe vepronin sipas ligjit islam. Kjo bëhet e ditur nga korrespondenca e Gjyqit të Naltë me Gjyqin e Sheriatit në Shkodër ku e njofton: *“Për çështjen e kompetencave të gjyqeve të sherives jemi në marrëveshje me Kryeministrinë. Përfundimi ju lajmërohet më vonë”*. Ndërsa Ministria e Drejtësisë në vitin 1922 njoftonte rrethet se sipas nenit 14 të organizimit të Sheriatit, iu caktohet detyrë vetëm shikimi i çështjeve të kurorës (nikah), shfuqizimi i kurorës (talak). mirëpo sipas këtij njoftimi disa gjykata sheriatike i kalonin kompetenca e tyre duke gjykuar edhe çështje që i përkasin gjyqit civil. Që gjykatat e sheriatit të merreshin vetëm me çështjet që rridhnin nga kurora si (nikah, talak) dhe me çështjet e ushqimit dhe se këto çështje zgjidhen dhe gjykohen me anë të klerit të çdo feje, vjen edhe urdhri i ri i ministrisë së Drejtësisë më 22 qershor 1922.³⁷

Në kongresin e vitit 1923, u bë organizimi i KMSH si dhe caktoi kompetenca në përputhje me ligjet në fuqi. KMSH doli si ent më vetëm, organizoi klerin, nëpunësit fetarë, shkollat dhe gjykatat fetare, të cilat kishin kompetencë të zbërthenin vetëm çështjet me karakter fetar, si: kurorëzime, divorce, trashëgimi si dhe administrimin e vakëvefe. Gjyqet e sheriatit administroheshin nga sekretarët e sherive. Prej vitit 1923 e gjer në prill të vitit 1929, myftinjët kishin për detyrë edhe gjyqet e sheriatit, sipas kompetenca të përcaktuara. Më 1 prill 1929, me hyrjen në fuqi të Kodit Civil, gjykatat e sheriatit u suprimuan duke jua hequr këto kompetenca myftinjve, të cilët tashmë mbanin vetëm administrimin dhe kontrollin e klerit. Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit doli me një njoftim ku theksonte, *“... me qenë se titulli i kadillëkut e i nijabetit si dhe fjala gjyq u hoqën (terdil), kryetarët e zyrave sherie këndeje e tutje do të mbajnë titullin myfti. Gjyqi i Naltë i Sheriatit qysh prej datës së vërtetimit të statutit prej Kongresit Mysliman merr titullin (Ynvani)”*.³⁸ Kjo reformë kishte filluar më herët, ku më 20 tetor 1928, Ministria e drejtësisë i kishte kërkuar Këshillit të Naltë të Sheriatit të krijojë një komision për reformat e sheriatit, i përbërë nga Xhemal

³⁷ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri, po aty, f. 23.

³⁸ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame, po aty, f. 80.

Naipi, Vejsel Naili, Raif Gonxhe, Hafiz Xhaferri dhe Suljeman Cani, me një buxhet paraprak prej 15 mijë franga ari.³⁹

Organizimi dhe administrimi i vakëfeve

Historia e vakëfeve në Shqipëri, të paktën në mënyrë zyrtare dhe të dëshmuar nga dokumentet historike, ka filluar me sundimin Osman. Gjatë shekujve, pasuria vakëfnore ka ardhur gjithnjë në rritje nëpërmjet dhurimit të pronave me qëllim bamirësie në mënyrë të vazhdueshme, si pasojë u krijuan një kategori e gjerë vakëfesh. Edhe pas pavarësisë, institucioni i vakëfit me gjithë ndryshimet që pësoi për shkak të rrethanave të reja politiko-ekonomike, numri i pronave vakëf erdhi duke u rritur. Ishin të shumtë personat dhe familjet, që i dhuronin pronat e tyre Komunitetit Mysliman të krijuar rishtas, kështu që vakëflënësit dhe pasuria vakëfnore erdhi gjithnjë në rritje. Në momentet e shpalljes së pavarësisë, në krye të vakëfeve qëndronte Mustafa Eshref Efendi. Mbas shpalljes së pavarësisë filluan të merren masat e para administrative nga qeveria e Vlorës për organizimin dhe menaxhimin e vakëfeve, detyrë që bashkë me çështjet e tjera fetare iu ngarkua H. Vehbi Dibrës.⁴⁰ Gjatë viteve 1912-1913, duket se kemi një amalgamë shqiptaro-osmane rreth menaxhimit të vakëfeve, kjo vihet re edhe në dy shkresa që gjenden në arkivin tonë që i përkasin vitit 1912. E para bën fjalë për një urdhëresë të ministrisë së vakëfeve për ngritjen e një medreseje në qytetin e Shkodrës.⁴¹ Ndërsa e dyta ministria e vakëfeve urdhëron nëpunësit e saj në Shkodër që të mos merren me politikë, të hapin shkolla të reja islame, etj.⁴²

Me organizimin e shtetit shqiptar filloi edhe vet administrimi i vakëfeve dhe aktivitetëve fetare me të ardhurat nga këto vakëfe. Një dokument arkivor tregon se në vitin 1913 kadiu i Shkodrës i drejtohej drejtorit të vakëfeve të Shkodrës për ta vënë në dijeni rreth shpenzimeve të bëra për meremetimin e xhamive dhe medreseve.⁴³ Në këtë kohë, institucioni i vakëfit u përfshi edhe në financimin e aktivitetëve shtetërore të Ismail Qemalit. Një telegram i parisë së Vlorës tregon për udhëtime dhe dieta të Ismail Qemalit të mbuluara nga pasuria e vakëfit.⁴⁴ Për sa i përket praktikave administrative, nga dokumentet

³⁹ Ali Basha, *Rrugëtimi i fesë islame*, po aty, f. 167.

⁴⁰ Smajl Bala, "Vakëfi-pasuria e komunitetit të myslimanëve", *Univers* 14(14), f. 144.

⁴¹ AQSh, Fondi 130, Dosja 43, f. 1.

⁴² AQSh, Fondi 130, Dosja 197, f. 1-17.

⁴³ AQSh, Fondi 143, Dosja 2001, f. 1.

⁴⁴ AQSh, Fondi 149, Dosja III/2164, f. 1-9.

arkivore bëhet e qartë se praktika e ndjekur ka qenë ajo e trashëguar nga sistemi osman. Një njoftim i vitit 1917, i Komandës së Qarkut Shkodër dërguar komisarit Françeskan i bën të ditur pagimin e të dhjetës nga kishat, manastiret, xhamitë e vakëfet sipas ligjit turk, që ka qenë më parë në veprim.⁴⁵ Pas vitit 1920 duket se hartohen edhe rregulloret e posaçme administrative të vakëfeve. Në vitin 1921, Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve i kërkon Kryeministrisë aprovimin e rregullores administrative të vakëfeve.⁴⁶ Gjithashtu arsimit fetar menaxhohej dhe financohej nga të ardhurat e vakëfeve, ruhen shumë dokumente që bëjnë të qartë bilancet e të ardhurave të vakëfeve të medreseve, xhamive, etj. Një raport i vitit 1919 i nënprefekturës së Kavajës, dërguar ministrisë së brendshme bën të qartë përdorimin e të ardhurave të vakëfeve për organizimin dhe mbarëvajtjen e arsimit.⁴⁷

Gjatë sundimit të Austro-Hungarisë në vitin 1916, drejtoria e vakëfeve ishte në varësi të Gjyqit të Naltë të Sheriatit. Drejtoria e re e vakëfeve nuk trashëgoi asnjë dokument apo inventar nga administrata e mëparshme që ishte drejtuar nga Mustafa Efediu.⁴⁸ Unë jam i mendimit se pohimi i mësipërm nuk është i saktë, sepse trashëgimia e administratës osmane të vakëfeve është shumë e pasur, por mungesa e evidencave dhe dokumentacionit vjen si pasojë e luftës dhe shkatërrimit të qyteteve shqiptare nga sulmet sllave, sidomos Shkodra. Drejtoria e re e Vakëfit e krijuar në Maj 1916, u angazhua me emërimin e kuadrit drejtues e administrativ. Filluan nga puna për nxjerrjen e evidencave të plota të pasurive vakëfnore, objektet e kultit, të arsimit, dyqaneve, tokave bujqësore, etj. Ata pasi bënë evidentimin e tyre në mënyrë të plotë e konvertuan vlerën e tyre në franga ari, sipas vlerës së kohës, gjë e cila përfundoi në tetor të 1917.⁴⁹ Bilancet dhe evidencat e hartuara të vakëfeve në Shqipëri, prej vitit 1923 filluan të botohen te *“Zani i Naltë”* sipas qyteteve dhe kategorive të tyre.

Në vitin 1923, u mbajt Kongresi I Mysliman Shqiptar dhe në krye të tij u konfirmua H. Vehbi Dibra. Nga vendimet e këtij kongresi ishte hartimi i një statusi zyrtar për Komunitetin Mysliman dhe një vend i veçantë i kushtohej organizimit dhe administrimit të vakëfeve. Në krye të administrimit të vakëfeve u zgjodh Sali Vuçiterni me 32 vota. Sipas

⁴⁵ AQSh, Fondi 133, Dosja 1516, f. 1.

⁴⁶ AQSh, Fondi 133, Dosja 1516, f. 1.

⁴⁷ AQSh, Fondi 149, Dosja VI/58, f. 1-9.

⁴⁸ Smajl Bala, “Vakëfi-pasuria e komunitetit të myslimanëve”, f. 144.

⁴⁹ Smajl Bala, “Vakëfi-pasuria e komunitetit të myslimanëve”, f. 145.

nenit 9 të statusit, aty ku kishte nëpunës vakëfi të ardhurat i dorëzoheshin atij, ndërsa aty ku nuk kishte nëpunës vakëfi të ardhurat dorëzoheshin në arkë, detyrë të cilën e kryenin sekretarët e myftinive. Sips nenit 32, vakëfet do të menaxhoheshin nga një drejtor i përgjithshëm, i cili do të zgjidhej nga kongresi i Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe që ishte i lidhur me Divanin (*Këshillin e Përgjithshëm të KMSH*). Në organikë bënin pjesë një drejtor, një sekretar, një arkëtar dhe një ndihmës. Në prefektura dhe nënprefektuar do të emëroheshin nëpunës të veçantë, të cilët në bashkëpunim me myftinjët do të menaxhonin jetën fetare në bazë të një rregulloreje. Përveç vakëfeve të teqeve, të gjithë vakëfet e tjera islame do të organizohen në atë që njihet si "*Tevhidi Evkaf*" dhe do të administrohen sipas "*Ahqemi Evkaf*". Rrogat dhe shpenzimet administrative do të siguroheshin nga të ardhurat që do të grumbulloheshin nga vakëfet dhe do të caktohen nga Divani.⁵⁰

Në Kongresin II që u mbajt në vitin 1925, u paraqit një evidencë me kërkesa të qarta për lirim të vakëfeve objekte dhe toka të zaptuara nga qeveria, siç ishte rasti i Medresës së Vlorës dhe asaj të Lushnjës. Në këtë kongres u diskutua edhe rregullorja e Drejtorisë së Vakëfeve ku përcaktonte të gjithë vakëfet në drejtim të kësaj drejtorie, ndërsa ata të teqeve në vrojtim të saj, rregullore e cila u kundërshtua nga një delegat dervish.⁵¹ Gjatë viteve 1923-1939, rregulloret për menaxhimin e vakëfeve erdhën duke u përmirësuar dhe duke u përshtatur me hapësirat ligjore. Gjatë kësaj kohe u hartuan regjistra të posaçëm për evidentimin e qartë, të vendit ku ndodheshin, përshkrimi fizik i tyre, të ardhurat që siguroheshin prej tyre, etj. Kjo situatë vazhdoi pothuajse gjer në fund të luftës së dytë botërore, me të vetmin ndryshim, që gjatë pushtimit italian si pasojë edhe e situatës së re të krijuar me aneksimin e territoreve shqiptare të Kosovës, abrogohen të gjithë institucionet dhe formohet Këshilli i Ulemave. Në krye të Vakëfeve emërohet Sali Vuçiterni.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, ashtu si e gjithë ekonomia shqiptare në përgjithësi, edhe ekonomia vakëfnore u përball me një krizë të thellë. Përveç dëmeve që ishin shkaktuar gjatë luftës mbi vakëfet dhe pronat e KMSH, në këtë proces ndikim të madh negativ patën edhe reformat ekonomike të ndërmarra nga qeveria Komuniste, të cilat nuk hezituan të vënë dorë dhe tjetërsojnë pronat vakëf. Megjithatë, bashkësia islame shqiptare bëri përpjekje maksimale për organizimin e jetës fetare dhe për ringritjen e vakëfeve. KMSH,

⁵⁰ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 73-81.

⁵¹ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 105.

zotëronte prona të mjaftueshme që i siguronin dhe garantonin vazhdimësinë normale të veprimtarisë së saj. Pronat e saj vakëf konsistonin në, toka, vreshta, ullishte, dyqane, punishte, etj. KMSH, konsiderohet si një nga pronarët më të mëdhenj në rang kombëtar (i dyti pas shtetit), ku përfshihen kategori të ndryshme pronash të lartpërmendura.⁵² Regjimi komunist për të goditur KMSH në aspektin ekonomik, nuk hezitoi të nxiste një grup personash në vitin 1945, që të krijonin një komision të posaçëm në qytetin e Vlorës për administrimin e vakëfeve. Ky komision do të vepronte i pavarur nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve në Tiranë. Veprimin e tyre ky grupim e justifikonte me faktin se me të ardhurat e vakëfeve në radhë të parë duhej të plotësoheshin nevojat lokale. Gjithsesi dukej hapur se politika e qeverisë komuniste synonte nxitjen e diversionit midis radhëve të bashkësisë islame.⁵³

Një vështirësi tjetër e institucioneve vakëfnore pas vitit 1945 ishte se një pjesë e tyre, në mënyrë arbitrare, përdorej nga shteti për interesa publike. P.sh.: në vitin 1947 xhamia e qytetit të Peqinit u përdor për strehimin e punëtorëve të hekurudhës, ndërsa godinat e vakëfit si zyra për administratën. Me gjithë protestat e vazhdueshme të KMSH, se qyteti nuk kishte xhami tjetër për plotësimin e nevojave të besimtarë, arbitrariteti dhe abuzimi vazhdoi. Mënyrë tjetër abuziviteti e qeverisë komuniste me vakëfet ishte edhe konfiskimi ose shpallja e tyre si monumente kulture, gjë që paralizonte veprimtarinë e tyre. Ajo që do t'i godiste më së shumti në aspektin ekonomik vakëfet, ishte reforma agrare e vitit 1945. Ligji i hartuar i mundësonte shtetit ndërhyrjen në pronat fetare dhe përdorimin e tyre në funksion të politikës së re ekonomike.⁵⁴ Ministria e Bujqësisë udhëzoi administratën lokale, që në ato zona ku nuk kishte tokë mjaftueshëm për bujqit të përdorëshin vakëfet. Nga një raport i hartuar nga KMSH në vitin 1946, rezultoi se 155 xhami në qytete të ndryshme të vendit ishin shpronësuar plotësisht nga reforma agrare.⁵⁵

Një goditje tjetër që regjimi komunist i dha vakëfeve ishin edhe pasojat që vinin nga politika fiskale. Kështu, më 31 mars 1945 u miratua ligji “*Mbi tatimin e fitimit*”, i cili tatonte të gjitha llojet e pasurisë duke

⁵² Studim mbi të drejtat e pronësisë të komuniteteve fetare në Shqipëri, Botim i Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale, Tiranë 2016, f. 61.

⁵³ <https://www.zaninalte.al/2017/11/vakefet-ne-shqiperi-nga-periudha-osmane-deri-ne-regjimin-komunist/>

⁵⁴ Shyqyri Hysi, “Reforma Agrare dhe Komuniteti Mysliman”, *Kërkime universitare*, Gjirokastër, nr. 6, 2002, f. 127-134.

⁵⁵ *AQSh*, Fondi 482, Dosja 224, f. 3.

përfshirë edhe rrogat e nëpunësve. Regjimi komunist përfshiu në listën e tij fiskale edhe vakëfet, pavarësisht se ato ishin institucione bamirësie. Masat represive mbi institucionet fetare dhe vakëfet vazhduan të shtoheshin vit pas viti, duke e ngushtuar aq shumë sferën e veprimtarisë së tyre sa që mbyllja e tyre do të vinte vetvetiu. Në vitin 1967 feja u ndalua me ligj, xhamitë u shkatërruan, ndërsa vakëfet u konfiskuan nga shteti. Në kushte të tilla ekzistenca e tyre mori fund.⁵⁶

Organizimi i arsimit islam dhe themelimi i Medresesë së Naltë të Tiranës

Me islamizimin e trevave shqiptare krahas xhamive u ndërtuan mejtepe (shkolla fillore) dhe në çdo zonë urbane (kasaba) kishte nga një medrese. Duhet pranuar që tradita e medreseve në Shqipëri është mbi 500 vjeçare, dhe sipas mendimit tim kjo ka qenë edhe arsyeja që shumë hoxhallarë ndër ta më të spikaturit ata të Shkodrës e kundërshtuan në fillim reformën arsimore dhe ishin kundër shkëputjes nga tradita e vjetër e medreseve. Në fillim të shek. XX, do të shohim se në të gjitha trojet shqiptare mejtepet do të zhvillonin edhe mësimin e gjuhës shqipe. Pas shpalljes së Pavarësisë, në mejtepet e trojeve shqiptare, që mbetën jashtë kufijve nuk u lejua mësimi i gjuhës shqipe. Me shpalljen e pavarësisë filloi edhe organizimi i rrjetit arsimor kombëtar, kjo nxori në pah edhe një herë traditën e mejtepeve ku të gjitha u kthyen në shkolla fillore kombëtare. Kjo është e theksuar sidomos për disa zona, ku midis dy luftërave botërore, kur u hapën medrese e shkolla shqipe, këto mejtepe dhe drejtuesit e tyre ishin të vetmet institucione fetare dhe shkencore. Mjaft prej tyre luajtën rolin e një shkolle të vërtetë shqipe. Në çerekun e parë të shekullit XX në Shqipëri më të njohura kanë qenë mejtepet e Shkodrës, si: mejtepi i Mulla Medos dhe Mulla Faslisë, të cilët ishin të njohura në shtypin e kohës që para pavarësisë. Lëndët e historisë, gjeografisë, aritmetikës etj., në këto mejtepe jepeshin shqip. Në mbarim të vitit shkollor 1911-1912 në mejtepin e Mulla Medos si edhe në atë të Mulla Faslisë qenë bërë, për herë të parë, provimet zyrtarisht me komision provues, me anëtarë nga personeli i shkollës qytetare ushtarake. Në qytetin e Shkodrës këto mejtepe vazhduan edhe pas vitit 1912. Për mbarëvajtjen e mejtepit të Mulla Medos u interesua dhe

⁵⁶ <https://www.zaninalte.al/2017/11/vakefet-ne-shqiperi-nga-periodha-osmane-deri-ne-regjimin-komunist/>

kryetari i Komisionit Ndërkombëtar për Shkodrën, koloneli anglez Filips, ku i dha drejtorit të mejtepit një ndërtesë të madhe.⁵⁷

Pas pavarësisë vazhdoi tradita e arsimit islam, siç ishte ai i mejtepeve dhe medreseve, mirëpo rrethanat e reja krijuan vështirësi ekonomike, sidomos me dobësimin dhe dëmtimin e disa vakëfeve që mbanin këto institucione arsimore. Se në ç'gjendje ishin këto institucione arsimore kuptohet nga *"Memorandumi"* që Myftiu i Përgjithshëm i dërgonte kuvendit kombëtar në vitin 1924, ku shprehesh edhe indinjata për mos mbështetje nga shteti Shqiptar, sepse arsimit islam nuk kishte asnjë mbështetje tjetër. Kërkesa paraqitej në formën e një ndihme ekonomike, ose të ktheheshin dhe të liroheshin vakëfet e zaptuara.⁵⁸

Një nga vendimet më të rëndësishme të Kongresit Mysliman të vitit 1923 ishte edhe hapja e një medreseje të lartë (Medreseja e Naltë) në Tiranë. Duket se arsyeja kryesore e këtij vendimi ishte ngritja e një institucioni model të arsimit të lartë fetar në vend. Ky institucion do të nxirrte kuadrot e larta fetare të nevojshme për burimet e duhura njerëzore dhe që do të pajiseshin me një nivel të lartë e të përshtatshëm akademik, si në aspektin e edukimit fetar, po ashtu edhe atë të edukimit me vlera kombëtare. Medreseja e Tiranës konsiderohet nga shkollat e para me arsim shqip të themeluara në kryeqytetin shqiptar, pasi atëherë ekzistonte vetëm Shkolla Teknike. Qëllimi fillestar ka qenë që ky institucion të ishte një universitet i mirëfilltë. Por pas 6 vitesh nga marrja e vendimit, pra në vitin 1929, ajo u quajt *"Medreseja e Përgjithshme"* dhe me atë rast u suprimuan edhe 12 medresetë tjera që ekzistonin në vend.⁵⁹ Kjo do të hapte një debat të madh ndërmjet hoxhallarëve dhe përfaqësuesve të fesë. Më 1924 në nivelin e gjimnazit klasik e teologjik, me personel tërësisht shqiptar u themelua *"Medreseja e Përgjithshme e Tiranës"*. Ajo u hap në bazë të vendimit Nr. 105/1 dhe Nr. 125/2 të Qeverisë Shqiptare. Në Shqipëri pati edhe medrese të tjera në të cilat denjësisht u arsimuan shqiptarët.⁶⁰

Vlen të përmendet gjithashtu se qysh në vitin 1924, Këshilli i Naltë i Sheriatit, në atë kohë institucioni zyrtar përfaqësues i myslimanëve të Shqipërisë, i kërkonte Ministrisë së Arsimit bashkëpunimin me këtë këshill për futjen e mësimin të lëndëve fetare dhe përzgjedhjen e mësuesve përkatës nëpër shkollat publike, si një nevojë dhe kërkesë e

⁵⁷ Ramiz Zekaj, Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shek. XX, f. 74.

⁵⁸ Ali Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 124.

⁵⁹ Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 83.

⁶⁰ Qazim Qazimi, <https://www.zaninalte.al/2013/09/zhvillimi-i-studimeve-islame-ne-ballkan/>

përhershme e popullit⁶¹. Kjo kërkesë nuk u pranua nga organet përkatëse dhe vazhdon të mos pranohet deri më sot e kësaj dite. Medreseja e Naltë e Tiranës do të kishte tre cikle shkollore; atë fillore, të mesme dhe të lartë. Secili cikël shkollor do të zgjaste 4 vjet. Pra arsimi i plotë në medrese zgjaste 12 vite. Nxënësit që kishin mbaruar filloren në medresetë e qyteteve të tjera, pas një provimi, mund të kalonin në ciklin pasardhës në Medresenë e Naltë. Sipas vendimit fillestar të insitucioneve zyrtare islame, në pamundësi të gjendjes financiare, çdo prefekturë do të zgjidhte nga 5 nxënës dhe do ti mbështeste ata me bursat e vakëfeve të prefekturave. Medreseja kishte edhe konviktin e saj i quajtur “*Lejli*”, shpenzimet e të cilit po ashtu mbuloheshin nga vakëfet, donacionet ose pagesat e prindërve.

Përveç lëndëve fetare si: Kur’an, Tefsir, Hadith, Besim, Histori Islame etj, nxënësit mësonin edhe lëndë tjera si: Gramatikë Arabe, Gjuhë Perse, Gjuhë Frënge, Mantik (Logjikë), Matematikë, Fizikë, Gjeografi, Vizatim, Higjienë etj. Nga mësuesit më të njohur që kanë dhënë mësim në medresenë e Naltë të Tiranës janë emra të dëgjuar si: Hafiz Ali Korça, Hafiz Mahmud Dashi, Sulejman Kadiu, Hafiz Ismet Dibra, Qamil Bala, Haki Sharofi, Ibrahim Dalliu etj. Ndërsa figura të njohura si Vexhi Buharaja, Shaban Demiraj, etj., janë disa prej nxënësve të saj. Në vitin 1931, ndërtohet godina e medresesë së Tiranës (*ndërtesa aktuale*), me projektimin e arkitektëve dhe inxhinierëve italianë dhe shqiptarë të kohës. Medreseja tashmë edhe si godinë edhe si produkt, ishte një nga institucionet më cilësorë të arsimit shqiptar.⁶²

Në vitin 1946, me fillimin e instalimit të sistemit komunist në Shqipëri, u shfaqën prirjet e para të “*luftës*” antifetare në vend dhe doli reforma arsimore që i kërkonte medresesë së Tiranës të ndryshonte programin e saj, duke reduktuar lëndët fetare e dukë i dhënë më shumë hapësirë lëndëve të mësimin laik. Edhe pse krerët e Komunitetit Mysliman në atë kohë reagueshan dhe kërkuan nga organet përkatëse anulimin e këtij vendimi, kërkesa e tyre u refuzua prerazi⁶³. Ky presion antifetar ndaj medresesë erdhi duke u rritur në vitet që pasuan. Sulmet e pabazuara në gazetata e ndryshme që transmetonin frymën komuniste, arrestimi i vazhdueshëm i mësuesve të medresesë (*p.sh. arrestimi i drejtorit të medresesë H. Ismet Dibrës si kundërshtar politik i regjimit*), provokimi i nxënësve që të braktisnin shkollën, etj., bënë që medreseja

⁶¹ “Zani i Naltë”, viti II, nr.2, prill 1925.

⁶² Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 93.

⁶³ Ali M. Basha, Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri 1912-1967, po aty, f. 469-472.

të përballlet me vështirësi të mëdha financiare dhe politike. Kështu që vitet që pasuan ishin mjaft të vështira për medresenë e Tiranës, derisa në vitin 1964, Medreseja mbyllet përfundimisht dhe godina e saj i kalon në përdorim institucioneve të tjera shtetërore.

Përfundim

Në këtë artikull jemi munduar të trajtojmë transformimin e jetës fetare në Shqipëri pas shpalljes së Pavarësisë si dhe pas shkëputjes nga Kalifati Islam. Pas humbjes së lidhjes institucionale me Stambollin, myslimanët shqiptar nxituan të krijonin strukturat e tyre të integruara tashmë në shtetin modern të sapo krijuar. Ky proces pati sfidat e veta, si: riorganizimi i institucioneve fetare, administrimi i vakëfeve dhe riaktivizimi i tyre në parametra modern ekonomik, institucionet arsimore dhe përshtatja e tyre me reformat e reja arsimore, themelimi i Medresesë së Naltë të Tiranës, etj. Pas shpalljes së Pavarësisë sfida më e madhe e hoxhallarëve shqiptarë ishte organizimi i jetës fetare duke ruajtur identitetin kombëtar dhe atë fetar në një realitet politik, gjë që nuk ishte e lehtë për ta, nëse kemi parasysh sfidat dhe rreziqet e kohës. Krijimi i institucioneve, si: ai i Kryemyftiut, Gjyqit të Naltë të Sheriatit, Komunitetit Musliman Shqiptar, tregoi përpjekjen dhe vizonin e atyre burrshtetasve shqiptarë dhe përpjekjen e tyre për një pavarësi institucionale fetare dhe kombëtare. Këto institucione jo vetëm garantuan vazhdimësinë e praktikës fetare në vend, por kontribuan edhe në ndërtimin e shtetit shqiptar, duke mbështetur arsimin dhe ligjin.

Me kalimin e viteve, reformat e reja sollën ndryshime edhe në rolin e institucioneve fetare. Gjyqet e Sheriatit, me miratimin e Kodit Civil më 1929, e humbën rolin dhe kompetencat e tyre. Gjithashtu vakëfet pësuan transformim dhe dëme të konsiderueshme me sfidat e reja ekonomike si dhe me ndryshimet urbanistike që solli zhvillimi urban i qyteteve. Megjithatë ata arritën të mbijetojnë dhe të kenë rol të rëndësishëm sidomos në sigurimin e mbarëvajtjes arsimore, si rasti i Medresesë së Tiranës, etj. Sfidat do të shtoheshin akoma më shumë me instalimin e regjimit komunist në Shqipëri, ku institucionet fetare u mbyllën, shkatërruan ose u përvetësuan, ndërsa pronat vakëfnore u konfiskuan. Përpjekjet e elitës fetare islame ishin të vazhdueshme, bile u përballën me arrestime, ekzekutime dhe kanosje të ndryshme.

Unë mendoj se në këtë kontekst, shqiptarët arritën të krijojnë një model të veçantë bashkëjetese midis fesë dhe kombit, ku fqinjët tanë e

kanë të vështirë ta ndajnë dhe liderët fetarë ishin njëkohësisht vizionarët e parë kombëtarë. Gjithashtu, shqiptarët arritën që gjatë regjimit komunist dhe mbylljes së fesë në vend, të krijojnë një model të veçantë mbijetese dhe të ruajtjes së besimit dhe identitetit të tyre fetar. Kjo u manifestua në mënyrë madhështore në ceremoninë e rihapjes së xhamisë së Plumbit në Shkodër më 16 nëntor 1990. Unë e shoh të domosdoshme që ne si mysliman shqiptarë, por kryesisht hoxxhallarët dhe institucionet fetare islame në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, të vazhdojnë të mbështesin akoma më shumë këto vlera kombëtare dhe të shërbejnë si referencë për trajtimin e sfidave të reja në shoqëri, ashtu siç shërbyen paraardhësit tanë.